



### FAKTE RRETH EKZAMINIMIT TË KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË

#### LLOJI I TESTIT: KOLONOSKOPI

Të gjithë mund të preken nga kanceri i zorrës së trashë. Ai mund të prekë personat e të gjitha racave dhe grupeve etnike. Ekzaminimi rutinë mund ta ndihmojë ofruesin e kujdesit shëndetësor që ta zbulojë kancerin më herët, kur trajtimi është më i lehtë. Gjithashtu, ekzaminimi mund të parandalojë kancerin, duke gjetur dhe hequr polipet ose zmadhimet anormale nga zorra e trashë.

Ekzistojnë opsione të ndryshme testi për ekzaminimin. Bisedoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor për të zgjedhur testin e duhur për ju.

**KUSH?** Personat me rrezik mesatar të kancerit të zorrës së trashë mund të kryejnë një kolonoskopi për t'u ekzaminuar për kancer të zorrës së trashë. Bisedoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor për moshën e nisjes së ekzaminimit. Nëse keni rrezik të lartë të kancerit të zorrës së trashë, mund t'ju duhet që të ekzaminoheni herët në kohë. Përpara se të zgjidhni testin, diskutoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor rreth historisë tuaj mjekësore dhe atë të familjes suaj. Tregojini nëse keni ndonjë nga këta faktorë rreziku:

- ▶ Histori kanceri të zorrës së trashë ose polipesh parakanceroze
- ▶ Një prind, motër ose vëlla ose fëmijë me kancer të zorrës së trashë ose polipe parakanceroze
- ▶ Polipozë familjare adenomatoze (Familial adenomatous polyposis, FAP) ose kancer kolorektal jopolipoz të trashëguar (hereditary nonpolyposis colorectal cancer, HNPCC), i quajtur edhe si sindroma Lynch
- ▶ Kolit ulcerativ ose sëmundje të Crohn-it

**ÇFARË?** Kur kryeni kolonoskopi, ofruesi i kujdesit shëndetësor përdor një kamerë të vogël për të kontrolluar për ind të pazakontë në zorrën e trashë dhe në rektum dhe heq polipet ose zmadhimet anormale. Kjo mund të parandalojë zhvillimin e kancerit ose të ndihmojë në gjetjen e hershme të tij, edhe nëse është tashmë i pranishëm. Ofruesi i kujdesit shëndetësor do t'ju japë anestezi (mjekim), i cili do t'ju sjellë gjumë përpara testit. Gjatë testit, ofruesi i kujdesit shëndetësor do të vendosë një tub të hollë në rektum, për të parë rektumin dhe zorrën e trashë nga brenda. Takimi mund të zgjasë disa orë, por testi zgjat vetëm rreth 30 minuta. Kur të zgjoheni, mund të mos e kujtoni që keni kryer

testin. Ofruesi i kujdesit shëndetësor do të diskutojë me ju kuptimin e rezultateve të testit. Nëse keni marrë anestezi, duhet të merrni me vete dikë që t'ju çojë në shtëpi pas testit, qoftë në këmbë, me metro, autobus ose makinë.

**KUR?** Ky test kryhet një herë në 10 vjet nëse keni rrezik mesatar të kancerit të zorrës së trashë.

**KU?** Ofruesi i kujdesit shëndetësor e kryen këtë test në një klinikë mjekësore ose në spital.

**PSE?** Kolonoskopia zbulon dhe parandalon kancerët e zorrës së trashë dhe rektumit. Nëse testi gjen kancer, ofruesi i kujdesit shëndetësor mund të jetë në gjendje ta heqë atë, përpara se të përhapet.

**SI?** Ditën përpara kolonoskopisë do të ndiqni një dietë të veçantë. Kjo dietë nuk përmban asnjë ushqim të fortë dhe lejohen vetëm lëngje transparente (asnjë pije bulmeti, me tul frutash ose me ngjyrë të kuqe ose vjollcë). Ofruesi i kujdesit shëndetësor do t'ju përshkruajë një ilaç (lëng për përgatitjen e zorrëve) që ta pini, i cili do t'ju bëjë që të dilni jashtë shpesh. Kjo e pastron zorrën e trashë përpara testit. Do t'ju duhet që të keni akses të lehtë në banjë. Në ditën e testit, nuk do të hani apo të pini asgjë. I vetmi përjashtim është pirja e më shumë lëngu për përgatitjen e zorrëve që ju pastron zorrën e trashë.

**A KA RREZIQE TESTI?** Kolonoskopia është zakonisht e sigurt dhe pa dhimbje. Ka një rrezik komplikimesh të rralla, si dehidratimi, probleme kardiovaskulare, infeksion ose shpim i zorrës së trashë ose gjakderdhje. Diskutoni rreziqet dhe përfitimet me ofruesin e kujdesit shëndetësor.

## CILI TEST ËSHTË I DUHURI PËR JU?

### LLOJI I TESTIT

### DALLIMET NË EKZAMINIMIN PËR KANCER TË ZORRËS SË TRASHË

#### REZULTATI I TESTIT

	KOLONOSKOPI	FIT*	HSgFOBT*	FIT-DNA*
Mund të zbulojë kancerin e zorrës së trashë	✓	✓	✓	✓
Mund të parandalojë kancerin e zorrës së trashë	✓	*	*	*
Kërkon një test vijues (kolonoskopi) nëse rezultatet janë anormale	—	✓	✓	✓
<b>PROCESI I TESTIT</b>				
Këtë test e kryeni në shtëpi	—	✓	✓	✓
Ju kërkohet që të mbani feçe	—	✓	✓	✓
Testin e kryeni një herë në vit	—	✓	✓	—
Testin e kryeni çdo tre vjet	—	—	—	✓
Testin e kryeni çdo 10 vjet	✓	—	—	—
Ofruesi i kujdesit shëndetësor e kryen këtë test në një klinikë mjekësore ose në spital	✓	—	—	—
Kërkon që të ndiqni një dietë të veçantë një ditë përpara	✓	—	—	—
Mund të kërkojë kufizim diete disa ditë përpara	—	—	✓	—
Zakonisht përfshin anestezi përpara	✓	—	—	—
Është procedurë e cila kontrollon brenda zorrës së trashë	✓	—	—	—
Përfshin rrezikun e komplikimeve të rralla, si shpimi i zorrës së trashë ose gjakderdhje	✓	*	*	*
Kërkohet shoqëruar deri në shtëpi	✓	—	—	—

\*Nëse ky test tregon rezultate anormale, nevojitet test i mëtejshëm nga kolonoskopia. Nëse kolonoskopia që vijon zbulon zmadhime anormale ose polipe, heqja e tyre mund të ndihmojë në parandalimin e kancerit.

#### PËRKUFIZIME:

FIT = testi imunokimik fekal

HSgFOBT = testi me ndjeshmëri të lartë, me bazë guajaku, i gjakut okult fekal

FIT-DNA = testi i ADN-së në feçe, për qëllime të shumëfishta

**KU KRYHET TESTI I KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË:** Flisni me ofruesin e kujdesit tuaj shëndetësor për të planifikuar një ekzaminim.

**PAGESA:** Pjesa më e madhe e planeve të sigurimit, duke përfshirë Medicaid dhe Medicare, i mbulojnë ekzaminimet e kancerit të zorrës së trashë, për personat me rrezik mesatar, duke filluar nga moshë 50 vjeçare. Nëse jeni ndërmjet moshës 45 dhe 49 vjeçare, mbulimi për ekzaminimin ndryshon. Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor për rrezikun e kancerit të zorrës së trashë dhe me ofruesin e sigurimeve rreth mbulimit, përpara testit ekzaminues. Nëse nuk keni sigurime, mund të kualifikoheni për t'u regjistruar për një mbrojtje me kosto të ulët ose pa kosto. Kur regjistroheni për një plan, mund të përfitoni ndihmë personale pa pagesë: Telefononi në numrin **311**.

**Njujorkezët pa sigurime mund të kualifikohen për ekzaminim me kosto të ulët ose pa kosto.**

**Për të mësuar më shumë rreth kancerit të zorrës së trashë dhe opsioneve të ekzaminimit, vizitoni [nyc.gov/health](http://nyc.gov/health) dhe kërkoni për "colon cancer" (kanceri i zorrës së trashë).**